



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
KANCELARI

Nr. 365 Prot.

Tiranë, më 25.02 2026

Lënda: Mbi monitorimin e shpenzimeve të Buxhetit për Akademinë e Shkencave, për periudhën Janar – Dhjetor 2025

Drejtuar: Ministrisë së Financave
Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit
Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit

TIRANË

Në mbështetje të Ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9 date 20.03.20218, “Per Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimi nr.14 datë 30.05.2023 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, bashkëngjitur po ju dërgojmë realizimin e shpenzimeve korente dhe kapitale, duke krahasuar treguesit e buxhetit të miratuar me ata faktikë, për periudhën Janar – Dhjetor 2025.

Për të gjitha anekset nuk ishte i mundur gjenerimi nga sistemi AFMIS, prandaj edhe plotësimi i tyre është bërë në mënyrë manuale, bazuar në akt – rakordimet me Degën e Thesarit Tiranë.

Nga ana e Akademisë së Shkencave janë bërë përpjekje maksimale për përdorimin me efikasitet të fondeve për realizimin e objektivave. Raporti monitorimit për periudhën Janar – Dhjetor 2025 krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KANCELARI

RUZHDIKUÇI



I. TABELA E PËRMBAJTJES

II. Hyrje

III. Informacion buxhetor i agreguar për buxhetin e ASH-së Janar – Dhjetor 2025

IV. Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore në nivel produkti

V. Performanca e buxhetit në nivel programi

V.1 Performanca financiare e programit buxhetor

V.2 Performanca jo - financiare e programit buxhetor

V.3 Veprimet vijuese në nivelin e programit buxhetor

VI. Projektet kapitale

VII. Nryshimet në buxhet

VIII. Përfundime

Aneksat bashkëlidhur:

- Aneksi nr. 1.0	Raporti përmbledhës i shpenzimeve të institucionit buxhetor
- Aneksi nr. 1.1	Raporti i shpenzimeve të institucionit buxhetor sipas kapitujve
- Aneksi nr. 1.2	Shpenzimet buxhetore në total programi dhe institucioni buxhetor
- Aneksi nr. 2.0	Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit"
- Aneksi nr. 2.1	Shpenzimet e programit sipas kapitujve
- Aneksi nr. 3.0	Raporti i performancës së produkteve të programit
- Aneksi nr. 3.1	Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve
- Aneksi nr. 3.2	Deviacioni i kostos për njësi në vite
- Aneksi nr. 4.0	Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit

II. HYRJE

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e themeluar më 1972, është institucioni më i rëndësishëm shkencor në Republikën e Shqipërisë. Akademia e Shkencave e Shqipërisë zhvillon veprimtarinë e vet në përputhje me misionin e saj që bazohet në Ligjin 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë”, në të cilin përcaktohet kuadri përparësive të mbështetjes ekonomike të veprimtarive për kërkim e zhvillim, që ato t’i përgjigjen më së miri zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Me fondet e buxhetit të vëna në dispozicion gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, Akademia e Shkencave ka ushtruar veprimtarinë e saj në zbatim të detyrimeve të ngarkuara sipas fushës së saj të përgjegjësisë e qëllimit të politikës së programit: “Fuqizimi i rolit të Akademisë së Shkencave, për të kryer misionin në zhvillimin e vendit, duke zbatuar prioritetet kombëtare në shkencë dhe nxitjes së kërkimeve në fushat përparësore, të zhvillimit ekonomik dhe teknologjik”. Realizimi i këtij qëllimi duke pasur si synim kryesor arritjen e disa objektivave: “Fusha të reja kërkimore të propozuara me interes shtetëror për rritjen e nivelit të kërkimit shkencor bazë, aplikimeve teknologjike dhe inovative në shërbim të zhvillimit multidisiplinor në mbështetje të strategjive ekzistuese si dhe atyre që do të formulohen”

“Fuqizimi i rolit të Akademisë së Shkencave, e aftë të kryejë misionin në zhvillimin e vendit, duke zbatuar prioritetet kombëtare në shkencë dhe nxitjes së kërkimeve në fushat parësore, të zhvillimit ekonomik dhe teknologjik”

“Punime shkencore të mbështetura financiarisht nga ASHSH kundrejt totalit të propozimeve të paraqitura në ASHSH”

“Kontribute shkencore për kërkim dhe zhvillim kundrejt totalit të fondeve të veprimtarisë”

“Kërkues të rinj shkencore të mbështetur kundrejt totalit të kërkuesve të mbështetur”.

Objekti i politikës së programit "Bashkëpunimi me institucione kërkimore dhe mësimore, brenda dhe jashtë vendit, që kanë kapacitetet e nevojshme fizike për kërkim, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit " synon të arrihet nëpërmjet:

1- Mbështetje financiare për punonjësit shkencore të A.SH.SH.

2- Transferimi i teknologjive inovative nga jashtë nëpërmjet bashkëpunimeve me rrjetin akademik ndërkombëtar, të rrjetit të akademive evropiane e të institucioneve kërkimore shkencore me të cilat A.SH.SH. bashkëpunon.

3- Kontribute shkencore për kërkim e zhvillim.

4- Zhvillime të veprimtarive shkencore kombëtare/ndërkombëtare: (konferenca, ëorkshope, seminare, tavolina të rumbullakëta, dite informimi, edukim shkencor) në bashkëpunim me partnere kombëtare e ndërkombëtare brenda dhe jashtë akademive.

5 - Kontribut i A.SH.SH. mbështetës në reformat e sistemit të kërkimit shkencor në vend në përgjithësi.

Misioni i ASH-së.

Misioni dhe veprimtaria e Akademisë së Shkencave orientohet dhe organizohet në zbatim të Kushtetutës, legjislacionit në fuqi, marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Akademia e Shkencave, programit të qeverisë në fushën e kërkimit shkencor dhe Statutit të ASH-së.

Akademia është institucion publik, përfaqësuesi më i lartë i shkencës e i kërkimit shkencor në vend, që vepron përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh. Akademia është institucion autonom në fushën e kërkimit, që e mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit. Akademia, si person juridik, është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve.

Me Vendim të Kuvendit nr.115/2023 është miratuar struktura dhe organika e ASH-së për 29 punonjës.

III. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR PËR BUXHETIN E ASH-SË JANAR – DHJETOR 2025

Buxhetimi i ASH-se është kryer sipas programit buxhetor “Veprimtari Akademike” (01520) në vlerën 549,680 mijë lekë.

Në këtë buxhet përballohen shpenzimet korente dhe kapitale për Institucionet.

- me kod 1022001 (ASH) – kap.1
- me kod 1022014 (Institutet e ASH) – kap 8 (rialokuar në vitin 2025 në grante).

Gjatë 12 mujorit vërehet një realizim të buxhetit prej 95,4% kundrejt buxhetit vjetor.

Numri i punonjësve të miratuar gjatë periudhës:

- Me Ligjin e Buxhetit nr.115/2024 për vitin 2025 numri i punonjësve të miratuar për ASH-në është 29 punonjës.
- Sipas Vendimit Nr. VKM nr.19 date 09/01/2025 “Për Përcaktimin e Numrit të Punonjësve me Kontratë të Përkohshme, për Vitin 2025, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” - 3 punonjës.
- Në zbatim të VKM Nr. 821, datë 28.12.2023 “Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave në Republikën e Shqipërisë” - 127 punonjës
- Sipas Vendimit nr. 298, datë 15.05.2024 “Për ngritjen e njësisë së kërkim-studimit me aktivitet afatgjatë “Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës” pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë e cila ushtron veprimtarinë në fushat e bioshkencës dhe të gjenetikës - 8 punonjës

IV. PERFORMANCA E TREGUESVE KYC TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

Në programin buxhetor 01520 "Veprimtari Akademike", produkti 92201AA (Veprimtaria shkencore të punonjësve të A.SH.SH. në përputhje me misionin e saj) adresohen çështjet e barazisë gjinore si:

- Numri akademikeve gra janë 8 ose 15% ndaj totalit të numrit të përgjithshëm të akademikëve.
- Numri i Botimeve Shkencore të publikuara nga gra akademike janë 19 nga 8 që ishte objektivi
- Përqindja e grave në poste drejtuese ndaj totalit të drejtuese është 3%.

Në vitin 2025 nga Kryesia e ASH-së janë miratuar 10 projekte me drejtuese gra, nga 18 projekte gjithsej të miratuara. Ky tregues u ruajt gjatë hartimit të PBA (faza perfundimtare) si një tregues i rëndësishëm i performances me bazë gjinore.

V. PERFORMANCA E BUXHETIT NE NIVEL PROGRAMI

V.1 Performanca financiare e programit buxhetor

Akademia e Shkencave buxhetohet vetëm nëpërmjet 1 (një) programi buxhetor i cili ka në strukturë 5 (pesë) produkte buxhetore.

- kodi 1022001 (ASH) – kap.1 ka këto produkte
 - o Kodi 92201AA - Veprimtaria shkencore e zhvilluar
 - o Kodi 92201AB – Produkte të kartave të eventeve për politikën shkencore dhe qeverisje
 - o Kodi 92201AC - Botime (revista dhe libra)
 - o Kodi 92201AE - Projekte madhore në Albanologji
- kodi 1022014 (Institutet e ASH) – kap 8 (rialokuar në vitin 2025 në grante) ka këtë produkt
 - o Kodi 92201AF - Trasferta për ASA

Ecuria e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik për Programin 01520 "Veprimtari Akademike", paraqitet si më poshtë:

✚ Ne art. 600 Paga realizimi është 93,1 %. Në këtë realizim përfshihen

1. Pagesat e kryera për administratën e ASH-së për 29 punonjës + 1 punonjës me kontratë (sipas VKM sipërcituar për këtë qëllim)
2. Njësive të Përhershme të Kërkim Studimit në Albanologji pranë Akademisë së Shkencave për 127 punonjës (sipas VKM sipërcituar për këtë qëllim) + 2 punonjës me kontratë (sipas VKM sipërcituar për këtë qëllim)

3. Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës për 8 punonjës, emëruar deri tani 4 punonjës (sipas VKM sipërcituar për këtë qëllim)

- ✚ Ne art. 601 *Sigurime Shogërore* realizimi është 95,8% - pagesa për sigurime shogërore dhe shëndetësore për ASH, Institutet dhe QKBGJ pranë ASH-së
- ✚ Ne art. 602 *Mallra dhe Shërbime të Tjera* realizimi është 97,6% - Në këtë realizim janë përfshirë shpenzimet operative për ASH, Institutet dhe QKBGJ pranë ASH-së.
- ✚ Ne art. 605 *Transferta Korente të Huaja* realizimi është 83,8% - për pagesën e kuotave të anëtarësisë të organizatave ndërkombëtare në të cilat aderohet Institucioni ynë.
- ✚ Ne art. 606 *Trans per Buxh. Fam. & Individ* realizimi është 99,5% - për pagesën për titullin "Akademik" sipas VKM-së nr. 302 datë 17.05.2023 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit mujor të përheshëm për titull të anëtarëve të asamblesë së Akademisë së Shkencave". Për periudhën raportuese janë kryer pagesa shpërblim për titull akademik për 53 akademik dhe akademik të asocuar.

Në lidhje me performancën e realizimit sipas shpenzimeve për produktet vihet re që:

- Në produktin 92201AA - Veprimtaria shkencore e zhvilluar – Ky produkt për vitin 2025 është realizuar në fakt për 24 projekte nga 25 të planifikuara për tu realizuar për vitin 2025, pra është realizuar në masën 97%
- Në produktin 92201AB – Produkte të kartave të eventeve për politikën shkencore dhe qeverisje (qendrore /vendore) të KSHT&I me impakt në K-Zh dhe prodhim – Ky produkt për 12-mujorin e vitit 2025 është realizuar në masën 99% të planit vjetor që i përgjigjet realizimit të ekspeditave, ligjërata të ndërsjella të akademikëve etj për 58 projekte nga 60 të planifikuara të cilat janë projekte për realizimin e punës kërkimore shkencore.
- Në produktin 92201AC - Botime (revista dhe libra) - realizimi i buxhetit është 96% që i përket pagesës për libra të publikuar deri në fund të vitit 2025 (botime dhe honorare).
- Në produktin 92201AE - Projekte madhore në Albanologji - Ky produkt për 12 – mujorin e vitit 2025 është realizuar në masën 100% të planit vjetor. Realizimi është për të 3 projektet madhore deri në fund të vitit.
- Në produktin 92201AF - Trasferta per ASA - realizimi i buxhetit është 93%. Ky produkt për 12 -mujorin e vitit 2025 është realizuar në fakt për të 6 projektet (njësitë).

Ecuri e mirë e realizimit të buxhetit paraqitet në të gjitha produktet (produkte në të cilat përfshihen edhe indikatorët me bazë gjinore) pasi në këto produkte përballohen shpenzimet për honorare, shpenzime për konferenca dhe aktivitete të ndryshme shkencore, projekte, botime monografi dhe revista periodike si dhe shpenzimet për 3 projektet madhore në Albanologji, ku realizimi mesatar për katër produktet (kap 1) është 98 %.

Në fund të vitit 2025, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin vjetor, paraqitet si më poshtë:

/ lekë

Veprimtaria Akademike	Plani me ndryshime	Fakti	% e realizimit
Shpenzime korrente	539,980,000.00	515,941,385.00	95.5
Shpenzime kapitale	20,000,000.00	18,102,433.00	90.5
Totali	559,980,000.00	534,043,818.00	95.4

Ndarë sipas natyrës përqindja e realizimit është si në tabelën më poshtë:

/ lekë			
Veprimtaria Akademike	Plani me ndryshime	Fakti Viti 2025	% e realizimit
Shpenzime personeli (600+601)	298,980,000.00	279,589,016.00	93.5
Shpenzime të tjera korrente	241,000,000.00	236,352,369.00	98.1
Shpenzime kapitale	20,000,000.00	18,102,433.00	90.5
Totali	559,980,000.00	534,043,818.00	95.4

Per investime kapitale për vitin 2025, për A.SH. buxhetimi i fondit është bërë në katër kode produkti:

Kodi i produktit	Emertimi	Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Shpenzime Faktike të Periudhës/ Progressive
18AF301	Blerje pajisje	4,000,000	5,500,000	4,723,036
24AJ001	Pajisje laboratorike për qendra kërkimore shkencore	6,000,000	4,500,000	3,894,597
25AC701	Blerje rafte murale	0	903,856	780,000
25AC601	Blerje pajisje për laboratorin	0	9,096,144	8,704,800
Totali		10,000,000	20,000,000	18,102,433

Realizimi i investimeve për periudhën 12 mujore paraqitet si vijon:

- Realizimi i kodit 18AF301 të projektit “Blerjeve per orendi e pajisje kondicionere dhe elektronike” është në vlerën 4,723,036, nga 5,500,000 lekë buxhet për vitin 2025. Me kete projekt jane kompletuar ambjentet e zyrove me pajisje dhe orendi zyre kryesisht në Institutet dhe Qendrat e Albanologjisë të cilat kishin mungesa të theksuara në pajisje në momentin e kalimit pranë A.SH..
- Në kodin 24AJ001 e projektit “Pajisje laboratorike për qendra kërkimore shkencore” nga totali i buxhetit të alokuar prej 4,500,000 lekë është realizuar në vlerën 900,000 lekë për pajisje nanoalb dhe 2,994,597 lekë për pajisje Bioteknologji dhe Gjenetikë e cila ka përmiresuar ndjeshëm infrastrukturën laboratorike të kërkimit shkencor për projektet e miratuara në bioteknologji dhe nanoalb të cilat vazhdojnë edhe gjatë vitit 2026.

- Me fondin shtesë sipas Aktit normativ Nr.6 datë 11.06.2025 prej 10,000,000 lekë, sipas kërkesave tona për investime, u realizuan keto projekte:
- Me kodin 25AC701 të projektit “Blerje rafte murale” nga totali i buxhetit prej 903,856 lekë është realizuar në vlerën 780,000 lekë, projekt i cili do të vazhdojë edhe në vitin në vazhdim. Deri me tani me realizimin e këtij projekti është siguruar ambjenti i përshtatshëm dhe i sigurtë për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
- Me kodin 25AC601 të projektit “Blerje pajisje për Laboratorët e Arkeologjisë dhe Antropologjisë” nga totali i buxhetit prej 9,096,144 lekë është realizuar në vlerën 8,704,800 lekë, me të cilin u plotësuan me pajisje laboratorike, Laboratorët e të dy Instituteve. Këto pajisje do të kryejnë trajtimin e objekteve prej qeramike në nivelin më të lartë, rikthimin termik të strukturës së dëmtuar të objekteve prej bronxi, bakri dhe argjendi si dhe përgatitjen e mostrave krahasuese për analizën bazuar në fluoreshencën e rezatimit X për gjetjen e vendprodhimit të objekteve prej qeramike. Po kështu pajisjet e blera do të ndihmojnë në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e fondeve të arkeologjisë dhe antropologjisë të zbuluara në vite.

Mosrealizimi i plotë të fondeve ka ardhur si rezultat i diferencës midis ofertës më të ulët të ofruar nga operatori fitues kundrejt fondit limit të përllogaritur.

Të ardhurat jashtë limiti të përdorura ne A.SH.

- Të ardhurat në kodin e Institucionit 1022001 i perkasin fondeve të trashëguara nga viti 2024 dhe çelur gjatë vitit 2025 nga AKKSHI si financuese për mbështetje të projekteve PKKZH dhe Bilaterale për vitet 2023 – 2025, pesha specifike e të cilave zë 96% të të gjithë fondit, sponsorizime nga donatore të huaj për aktivitete të mbajtura në A.SH. (të trashëgueshme në vitin pasardhës). Realizimi është kryer sipas buxhetit analitik të miratuar në këto projekte.
- Buxheti në kodin e Institucionit 1022014 i përket fondeve të mbartura nga viti 2024, të cilat nuk u përdoren gjatë vitit 2025 pasi nuk janë objekt i shpenzimeve sipas akteve ligjore të Ministrisë së Financave. Keto fonde nuk do të jenë të trashëgueshme për vitin 2026.

Buxheti dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit, si 12 - muor paraqitet si më poshtë:

Kod Ins. 1022001 (A.SH.)

Kap 6	Të mbartura nga viti 2024	Të ardhura gjatë vitit 2025	Të ardhura gjithsej gjatë vitit 2025	Të shpenzuara gjatë vitit 2025	Për tu trashëguar në vitin 2026
Të ardhura nga AKKSHI	23,996,290	12,380,779	36,377,069	15,068,589	21,308,480
Të ardhura nga sponsorizime të ndryshme	742,527	767,943	1,510,470	374,698	1,135,772
Totali	24,738,817	13,148,722	37,887,539	15,443,287	22,444,252

Kap 6	Të mbartura nga viti 2024	Të ardhura gjatë vitit 2025	Të ardhura gjithsej gjatë vitit 2025	Të shpenzuara gjatë vitit 2025	Për tu trashëguar në vitin 2026
Të tjera të mbartura	28,330,373	0	28,330,373	90,000	0
Të ardhura nga sponsorizime të ndryshme	610,913	1,614,452	2,225,365	1,825,210	400,155
Totali	28,941,286	1,614,452	30,555,738	1,915,210	400,155

V.2 Performanca jo - financiare e programit buxhetor

Realizimi i buxhetit për vitin 2025 i ka shërbyer realizimit të qëllimit të programit sipas problematikave në fushat prioritare duke zbatuar prioritetet kombëtare në shkencë, nxitjen e kërkimeve në fushat përparësore të zhvillimit ekonomik dhe teknologjik si mjedisi, burimet natyrore e të rinovueshme, etj. si dhe do të vazhdojnë veprimtaritë në fushat e arsimit, të shkencës, gjuhësisë, historisë, trashëgimisë kulturore, të ujit, energjisë etj.

Këtë e tregon edhe miratimi dhe akordimi i fondeve nga buxheti i ASH për mbështetjen e 24 projekteve në bioteknologji e gjenetikë, nanoalb dhe pasuritë ujore në vlef të 22,433,000 lekë si dhe 3 projektet madhore në albanologji dhe shkencat shoqërore në vlef të 60,000,000 lekë. Po kështu një peshë specifike zenë edhe shpenzimet për konferenca kombëtare dhe ndërkombetare, pagesat për anetarët e komisioneve të përhershme të ngritura pranë A.SH sipas fushave përkatëse të kërkimit shkencor si dhe koordinatorët e njësive dhe qendrave të përkohëshme të ngritura me vendim të Kryesisë së A.SH. për të cilat gjatë vitit është realizuar një fond prej 24,000,000 lekë.

Devijimi i kostos për njësi - Nga sa shihet në tabelat përkatëse nuk ka devijime të konsiderueshme.

- Ulje kostoje/njësi në produktin 92201AA (art.600, 601, 602, 606), në vlerën (-941,452 lekë) – devijim i cili argumentohet pasi për periudhën raportuese janë realizuar më shumë projekte me po të njëjtin buxhet në art. 602.
- Rritje kostoje/njësi, ka në produktin 92201AB në vlerën 23,172 lekë – devijim i cili pasi për periudhën raportuese (4-mujori i tretë) janë realizuar njësi produkti me peshë specifike të larte në buxhet, dhe konkretisht shpenzimet për tri konferencat si më poshtë:
 - Konferenca ndërkombëtare NanoBallkan 2025 në të cilën pati të ftuar nga bota shkencore ndërkombetare - konferencë e Njesisë së përkohshme Nanoballkan.
 - Konferenca ndërkombëtare “Shqipëria në periudhën Bizantine” - konferencë e komisionit të historisë me drejtues prof. Paskal Milo.

- Konferenca ndërkombëtare “Ndryshimet demografike dhe dinamika e tregut të punës – Sfidat e zhvillimit të qendrueshëm ekonomik në Shqipëri, Kosovë dhe Rajon” konferencë e komisionit të ekonomisë me drejtues akad. Anastas Angjeli.
- Ulje kostoje/njësi të vogla, ka në produktin 92201AC në vlerën - 48,892 lekë – devijim i cili pasi për periudhën raportuese janë realizuar njësi produkti me peshë specifike në buxhet më të ulët se mesatarja e njësive të produktit
- Rritje kostoje/njësi në produktin 92201AF (art.600, 601, 602 dhe 606), që i përket shpenzimeve për Institutet dhe Qendrat pranë ASH, në vlerën 7,127,115 lekë – Ky devijim argumentohet pasi në vitin 2025 pagesave për punonjësit e qendrave në këtë produkt i është shtuar edhe trajtimi me pagë i punonjësve të QKBGJ (Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës) sipas VKM të cituar më sipër si dhe realizimi i një numri më të madh ekspeditash arkeologjike krahasuar me vitin 2024.
- Ulje kostoje/njësi në produktin 92201AE është - 33,308 lekë – janë kryer pagesat për honorare të pjesëmarrësve në tre projektet madhore albanologjike pas marrjes në dorëzim të punës së kryer nga autorët gjatë vitit.

V.3 Veprimet vijuese në nivelin e programit buxhetor

Për ASH gjatë vitit 2025, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë kësaj periudhe, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Programet	Buxheti fillestar	Buxheti me ndryshime	në lekë
			Diferenca
Planifikim menaxhim administrim	549,680,000.00	559,980,000.00	10,300,000
Totali i ASH	549,680,000.00	559,980,000.00	10,300,000

Sikurse shikohet edhe nga tabela me sipër, ka pasur ndryshime në planin e buxhetit të Akademisë së Shkencave për këtë periudhë. Kjo shifër rakordon me:

1. Shtesën e vendosur në dispozicion për fondin e veçantë prej 300,000 lekë për vitin 2025.
2. Shtesë fondi për projekte me financim të brendshëm për 10,000,000 lekë, sipas Aktit Normativ Nr.6 datë 11.06.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për Buxhetin e vitit 2025”

VI. PROJEKTET KAPITALE

Nga sa kemi sqaruar si më sipër për vitin 2025 shpezimet kapitale janë buxhetur për kater projekte:

- Blerje pajisje me kod produkti 18AF301
- Blerje Pajisje laboratorike për qendra kërkimore shkencore me kod produkti 24AJ001
- Blerje rafte murale me kod produkti 25AC701 (Me akt Normativ)
- Blerje pajisje për laboratorin me kod produkti 25AC601 (Me akt Normativ)

Për statusin aktual të tyre ju kemi sqaruar në pikën V.1. Zbatimi i tyre është kryer sipas planit dhe kostove përkatëse të llogaritura.

VII. NRYSHIMET NË BUXHET

Gjatë periudhës që raportohet janë bërë ndryshime në buxhet sipas rialokimeve të përmendura më sipër.

VIII. PËRFUNDIME

Nisur nga realizimi 12-mujor i buxhetit për programin 01520 “Veprimtari Akademike”, programit të aktiviteteve të miratuara nga Kryesia e ASH-së, ecurisë së realizimit të projekteve për kërkim dhe zhvillim, dhe duke vlerësuar faktorët e jashtëm realizohen qellimi dhe objektivat e programit dhe nuk parashikohen ndryshime në qëllim, objektiva dhe akordim shpenzimesh.

Ky raport publikohet në faqen eeb të Akademisë së Shkencave: <https://akad.gov.al/raporte-financiare/>

Emri i Grupit Akademia e Shkencave		Kodi i grupit 22											
ENËRTIME		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit											
		VIII parashitja 2024			Periodua raportuese			Periodua raportuese			Periodua raportuese		
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	(1)	Plani Fillestar Vjetor VIII 2025	(3)	Struktura e shpenzimeve në %	(4)	Plani Vjetor i Rialikuar VIII 2025	(5)	Struktura e shpenzimeve në %	(6)	7 (5-3)
Shpenzimet sipas programeve buxhetore													
Kodi i Programit	Emërtimi												
01520	Veptrimet Akademike	481,360,789.65	100		549,680,000.00		100		559,980,000.00		100		
	Total i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01.02.03.04.05.06.22)	481,360,789.65	100		549,680,000.00		100		559,980,000.00		100		
	Shpenzime nga të Ardhurat jashtë limitit (Kap 06)	32,499,094.00			0.00				0.00				
	Total Shpenzimeve të Ministrisë	513,859,883.65			549,680,000.00				559,980,000.00				
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik													
Artikulli	Emërtimi												
600	Paga	217,577,161.00	45		49,000,000.00		8.9		256,680,000.00		45.6		207,980,000.00
601	Sqitje Shqetore	35,350,789.00	7		8,300,000.00		1.5		42,300,000.00		7.6		34,000,000.00
602	Materia dhe Shërbime të Tjera	156,944,146.65	32		127,900,000.00		23.3		177,900,000.00		31.6		50,000,000.00
603	Suavizime	0.00	0		0.00		0.0		0.00		0.0		0.00
604	Transferencia Korrente të Brendshme	0.00	0		291,880,000.00		53.1		0.00		0.0		-291,880,000.00
605	Transferencia Korrente të Huaja	591,285.00	0		600,000.00		0.1		600,000.00		0.1		0.00
606	Tirane per Buon Fam. & Individ	62,259,629.00	13		62,000,000.00		11.3		62,500,000.00		11.2		500,000.00
	Non-Totali Shpenzime Korrente	471,722,980.65	98		539,680,000.00		98.2		539,680,000.00		98.4		300,000.00
230	Kapitale të Patruqezuara	0.00	0		0.00		0.0		0.00		0.0		0.00
231	Kapitale të Trupëzuara	9,537,799.00	2		10,000,000.00		1.8		20,000,000.00		3.6		10,000,000.00
	Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	9,537,799.00	2		10,000,000.00		1.8		20,000,000.00		3.6		10,000,000.00
230	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0		0.00		0.0		0.00		0.0		0.00
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0		0.00		0.0		0.00		0.0		0.00
	Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.00	0		0.00		0.0		0.00		0.0		0.00
	Total Shpenzime Kapitale	9,537,799.00	2		10,000,000.00		1.8		20,000,000.00		3.6		10,000,000.00
	Total i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor	481,360,789.65	100		549,680,000.00		100.0		559,980,000.00		100.0		10,300,000.00
	Shpenzime nga të Ardhurat jashtë limitit (Kap 06)	32,499,094.00											17,358,497.00
	Total (korrente + kapitale + shpenz nga të ardh. jashtë limitit	513,859,883.65											551,402,315.00
	Numri i punonjësve (A.S.H. + ins. Alb. + me kontrate)	142			167				167				161

Sekretari i Përgjithshëm

Emri

Firma

Data

RUZHDI KUÇI

31.12.2025

ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve

Kodi i Ministrisë	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha e raportimit		Artikujt buxhetore										Total
			Perioda /Vite	Buxheti	230 Shpenzime kapitule të përfunduar	231 Shpenzime kapitule të trupëzuara	600 Pagat	601 Kontit e Sigurimeve Shëndetësore	602 Mallja dhe Shërbime	603 Sulveci- net	604 Të tjera Transfer Korrente Buxhetore	605 Transfer Korrente të tjerë	606 Transfera për Buxhetet Familjare dhe individë		
22	01	Nga Buxheti	2025	Plani fillestar	0	10,000,000	49,000,000	8,300,000	127,900,000	0	291,880,000	600,000	62,000,000	549,680,000	
22	01	Nga Buxheti	2025	Plani i rishikuar	0	20,000,000	49,000,000	8,300,000	127,900,000	0	0	600,000	62,300,000	268,100,000	
22	01	Nga Buxheti	2025	Fakti	0	18,102,433	46,906,767	7,126,271	127,025,186	0	0	502,947	62,027,477	261,691,081	
22	01	Nga Buxheti	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
22	08	Granti i Universitarit,	2025	Plani fillestar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
22	08	Granti i Universitarit,	2025	Plani i rishikuar	0	0	207,680,000	34,000,000	50,000,000	0	0	0	200,000	291,880,000	
22	08	Granti i Universitarit,	2025	Fakti	0	0	192,162,647	33,393,331	46,646,759	0	0	0	150,000	277,352,737	
22	08	Granti i Universitarit,	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
22		Total	2025	Plani fillestar	0	10,000,000	49,000,000	8,300,000	127,900,000	0	291,880,000	600,000	62,000,000	549,680,000	
22		Total	2025	Plani i rishikuar	0	20,000,000	256,680,000	42,300,000	177,900,000	0	0	600,000	62,500,000	559,980,000	
22		Total	2025	Fakti	0	18,102,433	239,069,414	40,519,602	173,671,945	0	0	502,947	62,177,477	534,043,818	
22		Total	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
22		Ndryshimi në vlerë absolute	2025		0	1,897,567	17,610,586	1,780,398	4,228,055	0	0	97,053	322,523	25,936,182	
22		Realizimi në %	2025		0	91	93	96	98	0	0	84	99	95	
22	06	Nga të ardhurat jashtë limitit	2025	Fakti	90,000	0	1,825,210	0	12,797,009	0	2,646,278	0	0	17,358,497	
22	06	Nga të ardhurat jashtë limitit	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	

Drejtori i Ekspert Menaxhues të Programit		Emri		Firma		Data		Emri		Firma		Data	
		VASIL S. TOLLE				31.12.2025		RUZHDI KUÇI				31.12.2025	

